

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kushtetuesja në Bosnje ndalon financimin për lobim lidhur me shkëputjen e Republikës Sërpska
ADRESA	https://dosja.al/bota/kushtetuesja-ne-bosnje-ndalon-financimin-per-lobim-lidhur-me-shkep-utjen-e-r-i516021
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 15:28:56 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 15:25:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	7bec3068ba320dfe032f0fd3520095ee9dc1baecb62aa2f555046b3fb39cd89b
TEKSTI	003de6dd571332803f5d2a8cf9c8c9559e78503a56e671be0becaf592d36c136
PAMJA	37bab24bee514144bbbbc89096ae38514af48e230e641a7a068a61982e9ce4ea

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	47117688503980e823fddac330e2405d91350023be80d413e996030f1227dfdd
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	77d68db3023b2e51e8611bf6d5eddb24bf36cfc38da7912fff4d1353a313a25f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/47117688503980e823fddac330e2405d91350023be80d413e996030f1227dfdd>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES

12 MINUTA ME PARE

"Shqipëria e shqiptarëve është slogan i neveritshëm dhe i turpshëm"/ Rama: SHBA tradhtoi Hashim Thaçin, George Washingtonin e Kosovës

2 ORE ME PARE

Konflikt në Durrës/ Shefi i Policisë së Krujës përplasat fizikisht me pronarin e ish-hotelit "Mira Mare": Nuk e kam kërcënuar, më shau, e shava

18 ORE ME PARE

Tensione dhe braktisje salle në OKB/ Netanyahu sulmon Turqinë e Katarin, paralajmëron rënien e regjimit iranian. Mamdani: Përdori fjalimin e tij për të përsëritur gënjeshtra të pabaza

22 ORE ME PARE

Dita e 117-të e protestës/ Qytetarët zbresin sërish në shesh, kërkohet dorëheqja e kryeministrit Rama: Ju erdhi fundi!

Bota

Kushtetuesja në Bosnje ndalon financimin për lobim lidhur me shkëputjen e Republikës Sërpska

Gjykata Kushtetuese e Bosnjës i shpalli antikushtetuese fondet prej miliona eurosh të ndara nga Republikën Sërpska për lobim jashtë vendit, përfshirë edhe një kontratë që Përfaqësia e Republikës Sërpska në Vjenë e kishte lidhur me kompaninë kanadeze "Dickens & Madson".



25 Shtator 2026, 17:25
Nga E.d



Një seance e Gjykatës Kushtetuese të Bosnje e Hercegovinës

Gjykata Kushtetuese e Bosnje e Hercegovinës vendosi të premtën t'i ndalojë pagesat nga buxheti i Republikës Sërpska për lobim, përfshirë paratë për të financuar kontratat e lobimit që lidhen me avokimin për shkëputjen e entitetit serb nga shteti i Bosnjës.

Vendimi lidhet me zërin buxhetor "Transferet për përfaqësitë e Republikës Sërpska jashtë vendit", i paraparë në buxhetin e këtij entiteti për vitin 2026 në vlerë prej rreth tetë milionë eurosh, si dhe me të njëjtin zë në rishikimin e dytë të buxhetit për vitin 2025, ku ishin paraparë rreth 25 milionë euro.

Gjykata Kushtetuese e Bosnjës i shpalli antikushtetuese fondet prej miliona eurosh të ndara nga Republikën Sërpska për lobim jashtë vendit, përfshirë edhe një kontratë që Përfaqësia e Republikës Sërpska në Vjenë e kishte lidhur me kompaninë kanadeze "Dickens & Madson".

Gjykata ndaloi njëkohësisht të gjitha pagesat nga buxheti i Republikës Sërpska në bazë të kësaj kontrate, si dhe financimin e angazhimeve të tjera për lobim, qëllimet e të cilave janë në kundërshtim me Kushtetutën e Bosnje e Hercegovinës, vendimet e Gjykatës Kushtetuese dhe institucionet shtetërore të vendit.

Kushtetuesja e mori vendimin pas kërkesës së Denis Zvizdiqit, nënkryetar i Dhomës së Përfaqësuesve të Asamblesë Parlamentare të Bosnje e Hercegovinës.

Në kërkesën e tij, Zvizdiq kërkoi që Gjykata Kushtetuese të zgjidhte një mosmarrëveshje mes Bosnje e Hercegovinës dhe entitetit të saj, Republikës Sërpska, lidhur me miliona euro të ndara për përfaqësitë e këtij entiteti jashtë vendit, përfshirë fondet e përdorura për financimin e kontratave të lobimit që lidhen me promovimin e pavarësisht të Republikës Sërpska.

editoriale

Eriseld Zeneli

Shqipëria, socializmi i Edi Ramës pa të majtën

Irena Beqiraj

Kostot e jetesës edhe lajmi se ekonomia po ecën mirë

Në vëmendje

AKTUALITET 25 SHTATOR 2026, 12:08

"Të q*fsha motrën"/ Shefi i Policisë së Krujës shan qytetarin, ai zbret nga makina dhe e qëllon me shpullë (VIDEO)

POLITIKE 25 SHTATOR 2026, 10:13

BIRN: Zyrtarët e lartë dhe krimi i organizuar u bënë njësh në mbrojtje të Ergys Agasit



Zvizdiq e kishte dorëzuar kërkesën në prill të këtij viti.

“Qëllimi i kërkesës sime është që Gjykata Kushtetuese e Bosnje e Hercegovinës t’i ndalojë të gjitha pagesat buxhetore nga të gjitha nivelet e pushtetit në Bosnje për lobim për synime antikushtetuese dhe të paligjshme, të cilat janë në kundërshtim me Kushtetutën e Bosnje e Hercegovinës, ligjet e saj, vendimet e Gjykatës Kushtetuese dhe institucionet e Bosnje e Hercegovinës”, kishte deklaruar atëherë Zvizdiq.

Ai kishte paralajmëruar gjithashtu se “shpenzimi i parave të buxhetit nuk duhet të orientohet drejt cenimit të integritetit territorial dhe sovranitetit të shtetit të Bosnje e Hercegovinës”.

Kontrata me “Dickens & Madson”

Sipas një hulumtimi të Radios Evropa e Lirë, Republika Sërpska ka paguar katër milionë dollarë nga buxheti i saj për lobistë në Uashington, për të promovuar pavarësimin e këtij entiteti nga Bosnje e Hercegovina.

Sipas të dhënave nga një bazë amerikane, të analizuar nga REL-i, kontrata e fundit me kompaninë izraelito-kanadeze “Dickens & Madson” është pjesë e një fushate shumëvjeçare lobimi të autoriteteve të Republikës Sërpska në Shtetet e Bashkuara.

Për këtë fushatë, që nga viti 2015, janë ndarë të paktën 8.3 milionë dollarë. Ndër synimet e saj ishin heqja e sanksioneve amerikane ndaj ish-presidentit dhe kryeministrit të Republikës Sërpska, Millorad Dodik, si dhe kundërshtimi i legjitimitetit të përfaqësuesit të lartë ndërkombëtar, Christian Schmidt.

Shtetet e Bashkuara i hoqën sanksionet ndaj Dodikut dhe bashkëpunëtorëve të tij në vitin 2025, ndërsa Schmidt dha dorëheqje nga posti në maj të këtij viti.

Autoritetet e këtij entiteti kishin paraparë edhe 54.9 milionë marka (rreth 28 milionë euro) për aktivitetet e lobimit në rishikimin e buxhetit për vitin 2025.

Fondet për lobim u miratuan nga shumica qeverisëse në Asamblenë Kombëtare të Republikës Sërpska, e udhëhequr nga Aleanca e Socialdemokratëve të Pavarur e Dodikut.

Republika Sërpska nuk ka të drejtë të shkëputet

Sipas kuadrit kushtetues në fuqi, entitetet e Bosnje e Hercegovinës nuk kanë të drejtë të shkëputen nga shteti dhe as të ndryshojnë në mënyrë të njëanshme integritetin e tij territorial.

Në një vendim të mëhershëm, të vitit 2008, Gjykata Kushtetuese e Bosnje e Hercegovinës kishte vlerësuar se Republika Sërpska mund të angazhonte lobistë për promovimin e interesave të veta. Gjykata në atë rast kishte hedhur poshtë pretendimet se një veprim i tillë cenonte kompetencat ekskluzive të shtetit në fushën e politikës së jashtme.

Megjithatë, Zvizdiq argumentoi në kërkesën e tij se rasti aktual dallon, pasi fondet e buxhetit po përdoren për aktivitete që lidhen drejtpërdrejt me promovimin e pavarësimit të Republikës Sërpska, gjë që, sipas tij, është në kundërshtim me Kushtetutën e Bosnje e Hercegovinës dhe vendimet e mëhershme të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare./REL

bosnje e hercegovina sërpska kushtetuesja

Sondazh

Poll

AKTUALITET 25 SHTATOR 2026, 07:44

"O Kriminel, o mafia"/ Shqiptarët qëllojnë me vezë Edi Ramën në SHBA: E gjithë Shqipëria ty të urren

më të klikuarat

"Të q"fsa motrën"/ Shefi i Policisë së Krujës shan qytetarin, ai zbrret nga makina dhe e qëllon me shpullë (VIDEO)



"O Kriminel, o mafia"/ Shqiptarët qëllojnë me vezë Edi Ramën në SHBA: E gjithë Shqipëria ty të urren

Plagosja e të riut në Lezhë/ Pagesa e riparimit të makinës bëhet "mollë sherri", kamerat e sigurisë zbardhin konfliktin! Autorët u larguan me makinë, babë e bir në kërkim (EMRAT)

Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, kryeministri Rama mban sot fjalimin e tij në hapje të debatit

insights

Rezarta Gagani
Përballë pallatit tim po ndërtohet një pallat

Auron Janku
Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Ola Xama
Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari
Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Moti

Powered by tomorrow

Beta

25 Shtator 2026, 14:52

Mali i Zi vendos viza për shtetasit nga Rusia, Bjellorusia dhe Turqia

Një pasaportë ruse. Qeveria e Malit të Zi miratoi Informacionin për nevojën e anulimit të marrëveshjeve me të cilat...

Kapet një kontejner me 24 tonë mish të skaduar, ishte destinuar për "Apetit" në Kosovë

Beta

25 Shtator 2026, 14:29

Papa Leo XIV nis sot vizitën në Francë, pritët nga qindra mijëra besimtarë

Beta

25 Shtator 2026, 14:12

Vuçiq akuzon Nenad Rashiq: Po zbaton verbërisht urdhrat e Albin Kurtit

Beta

25 Shtator 2026, 14:09

Nga Titanët e teknologjisë te "Kurthi i Thukididit" dhe dollia simbolike/ PRAPASKENAT e darkës Trump-Xi në Shtëpinë e Bardhë

Beta

25 Shtator 2026, 10:20

Bota

25 Shtator 2020, 10:15

Ministri i Jashtëm iranian: I kemi paraqitur SHBA-së planin për rihapjen e Hormuzit

Abbas Araghchi IRANË- Ministri i Jashtëm iranian, Abbas Araghchi tha se Teherani i ka paraqitur Shteteve të Bashkuara një plan për...

Teksa Trump dhe Xi takohen, rritet presioni për konfrontimin me Kinën për mbështetjen ndaj Iranit

Bota

25 Shtator 2020, 09:07

"Swan Song: Diana, motra ime"! Pse një libër për Princeshën Diana po shkakton kaq bujë?

Bota

25 Shtator 2020, 08:31

Analiza e DW: Ekonomia gjermane po rimëkëmbet, por për sa kohë?

Bota

25 Shtator 2020, 08:13

Aleksandër Vuçiç: Do të japë dorëheqjen të dielën në mbrëmje, por do të flas me Putinin para përfundimit të mandatit

Bota

25 Shtator 2020, 08:02

MË SHUMË





Rama nga SHBA: Ka forca që nuk kanë qejf të na shohin kështu



Rama: SHBA tradhtoi Hashim Thaçin, George Washingtonin e Kosovës!



Pamje të rënda nga atentati në Sarandë! Artan Myrtaj vrapon për t'u shpëtuar plumbave...



"O Kriminel, o mafia"/ Shqiptarët qëllojnë me vezë Edi Ramën në SHBA: E

Rama nga SHBA: Ka forca që nuk kanë qejf të na shohin kështu



Shiko video te tjera



KTHEHU NE KRYE



Dosja.al është një iniciativë gazetarësh të rinj dhe njerëzish të lirë, që nuk ndikohet nga interesa politike apo biznesi. Informimi i paanshëm, qindrimi i pavarur dhe etika profesionale janë parimet tona. Ka media të majta, të djathta, ka media në shërbim të partive apo biznesit, por ka edhe të pavarura, që kanë zgjedhur rrugën më të vështirë, por më të ndershme dhe më të sigurtë për të qenë të besueshëm. Dosja.al do të jetë gjithmonë e pavarur, e vërtetë, në krah të interesit publik.

© 2017 Dosja.al. Të gjitha të drejtat rezervohen.

AKTUALITET

POLITIKE

EKONOMI

BOTA

Drejtör: Enton Abilekaj

Kryeredaktor: Izmir Akulli

Gazetarë:

Esmeralda Doçi

Emanuela Dida

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.